2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqese një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetëdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore në vendin ku ushtron veprimtarinë sipas liçensës të kërkuar në kriterin 2.3.2

Shënim: Operatoret ekonomik të kualifikuar të sukseshëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi /fruta-perime në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (nje) mjet transporti ATV (frigoriferik) për transportin e produkteve ushqimore/fruta-perime. Mjeti mund të jenë në pronësi, qera apo përdorim sipas rregullimeve ligjore. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë si :

- a. Akti që vërteton pronësinë ose Kontratë qeraje apo përdorimi (e vlefshme),
- b. Leje qarkullimi,
- c. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm),
- d. Sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (të vlefshëm).
- e. Fotografi te mjetit ku te evidentohet targa.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet te dorezoje prane AK, dokumentat provuese per vetdeklarimet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit,sic kerkohet ne piken 2..3.6,duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

- 2.3.7** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, për të realizuar shërbimin e transportit dhe shpërndarjen e artikujve ushqimorë objekt prokurimi sipas lotit 1 në destinacion, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1 një
Punonjes shperndarje	1 një
Total	2 dy

- Për punonjësit e punësuar të paraqitet kontratë pune (e vlefshme).

Kriteri konsiderohet i permbyshur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sic kërkohet në piken 2.3.7, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.

- 2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatat (të vlefshme), si më poshtë:

- Çertifikatën SSH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*
- Çertifikatën SSH EN ISO 9001:2015 për “Menaxhimin e cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s’kualifikim.

➤ **Loti Nr. 3: “Blerje Bulmetra”**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 9).*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023 dhe 2024**, lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës e përkatësisht **2,725,032 (dy milion e shtatëqind e njëzet e pesëmijë e tridhjetë e dy) lekë**.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2025 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ,duhet te dorezoje prane AK ,dokumentat provuese per vetdeklarimet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit,sic kerkohet ne piken 2.2.3,duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit, që prokurohet dhe konkretisht **1,362,516 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë e dymijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë**.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licensë me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të prokurimit të lotit 3 si më poshtë:

- a. Licensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtme:
 - Kategoria: II.1 Prodhim dhe/ose tregtimi i ushqimeve.
 - Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.
- b. Licensë e mësipërme duhet të jetë e shoqëruar nga Akti i miratimit të zhvillimit të aktivitetit të lëshuar nga QKB dhe
- c. Licensë të kategorisë “II.1.B - Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)” të lëshuar nga QKB (e vlefshme).

(Sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore).

- 2.3.3** Nëse veprimtaria specifike sipas liçensës së operatorit ekonomik nuk është në përputhje me objektin e prokurimit të lotit 3 ky i fundit duhet të disponojë kontratë /a furnizimi nga subjekte që e zotërojnë Liçensën e kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” me veprimtari specifike sipas objektit të prokurimit (Lotit 3).
- a. Për të përmbushur këtë kriter duhet të paraqitet kontrata/t e furnizimit të vlefshme dhe Liçencë të kategorisë “II.1.A.1-Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të furnitorit me veprimtari specifike sipas objektit të prokurimit (Lotit 3), e vlefshme të lëshuar nga QKB.
- 2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës në rast se është prodhues duhet të paraqesë **Leje Mjedisi të tipit A ose B në emër të tij me përshkrim të veprimtarisë ID 7.7 /e “Trajtimi dhe përpunimi i qumështit”** të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- 2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetëdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore në vendin/et ku ushtron veprimtarinë sipas liçensave të kërkuara në kriterin 2 .
Shënim: Operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.
- 2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi/bulmet dhe nënproduktet e tij në adresat e përcaktuara nga Autoritetet Kontraktore përfituese potenciale.
- 2.3.7** Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 (dy) mjete transporti ATV (frigoriferik) për transportin e produkteve ushqimore/bulmet dhe produktet e tij. Mjetet mund të jenë në pronësi, qera apo përdorim sipas rregullimeve ligjore. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë si:
- Akti që vërteton pronësinë ose Kontratë qeraje apo përdorimi (e vlefshme),
 - Leje qarkullimi,
 - Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm),
 - Sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (të vlefshëm).
 - Fotografi të mjeteve ku të evidentohet targa.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ,duhet të dorëzojë pranë AK ,dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit,sic kërkohej në pikën 2.3.7,duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.

- 2.3.8** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, për të realizuar shërbimin e transportit dhe shpërndarjen e artikujve ushqimore objekt prokurimi sipas lotit 2 në destinacion, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1 nje
Punonjes shperndarje	1 nje

Total	2 dy
-------	------

- Për punonjësit e punësuar të paraqitet kontrate pune (e vlefshme).
- *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.*
Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ,duhet te dorezoje prane AK ,dokumentat provuese per vetdeklarimet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit,sic kerkohet ne piken 2.3.8, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatat (të vlefshme), si më poshtë:

- Çertifikatën SSH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*
- Çertifikatën SSH EN ISO 9001:2015 për “Menaxhimin e cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

➤ **Loti Nr. 4: “Blerje mish viçi dhe pule”**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 9).*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023 dhe 2024**, lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës e përkatësisht **1,266,488 (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori

ushtron aktivitet për vitin 2025 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ,duhet te dorezoje prane AK ,dokumentat provuese per vetdeklarimet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit,sic kerkohet ne piken 2.2.3,duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

- 2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit *nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës/lotit, që prokurohet dhe konkretisht **633,244 (gjashëqind e tridhjetë e tremijë e dyqind e katërdhjetë e katër) lekë.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- 2.3.2** Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë liçensë me emërtimin përshkrues të veprimtarisë specifike sipas objektit të prokurimit të lotit 4 si më poshtë shënuar:

- Liçensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtme:
-Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.
-Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.
- Licensa e mësipërme duhet të jetë e shoqëruar nga Akti i miratimit të zhvillimit të aktivitetit të lëshuar nga QKB dhe
- Liçensë të kategorisë “II.1.B-Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)” të lëshuar nga QKB (e vlefshme).

(Sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Liçensës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore).

- 2.3.3** Nëse veprimtaria specifike sipas liçensës së operatorit ekonomik nuk është në përputhje me objektin e prokurimit të lotit 4 ky i fundit duhet të disponojë kontratë /a furnizimi nga subjekte që e zotërojnë *Liçensën e kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”* me veprimtari specifike sipas objektit të prokurimit (Lotit 4).

- Për të përmbushur këtë kriter duhet të paraqitet kontrata/t e furnizimit të vlefshme dhe *Liçencë të kategorisë “II.1.A.1-Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”* të furnitorit me veprimtari specifike sipas objektit të prokurimit (Lotit 4), e vlefshme të lëshuar nga QKB.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës nëse është prodhues duhet të paraqesë **Leje Mjedisi të tipit A ose B në emër të tij me përshkrim të veprimtarisë ID 7.7/a për thertore**, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetëdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore në vendin/et ku ushtron veprimtarinë sipas liçensave të kërkuara në kriterin 2.3.2.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojnë minimumi 1 (nje) mjet transporti ATV (frigoriferik) për transportin e produkteve ushqimore/mish dhe produktet e tij. Mjetet mund të jenë në pronësi, qera apo përdorim sipas rregullimeve ligjore. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë si :

- a. Akti që vërteton pronësinë ose Kontratë qeraje apo përdorimi (e vlefshme),
- b. Leje qarkullimi,
- c. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm),
- d. Sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (të vlefshëm).
- e. Fotografi te mjeteve ku te evidentohet targa.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet te dorezoje prane AK ,dokumentat provuese per vetdeklarimet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit,sic kerkohet ne piken 2.3.7,duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, për të realizuar shërbimin e transportit dhe shpërndarjen e artikujve ushqimore objekt prokurimi të lotit 4 në destinacion, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1 nje
Punonjes shperndarje	1 nje
Total	2 dy

Për punonjësit e punësuar të paraqitet kontrate pune (e vlefshme).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ,duhet te dorezoje prane AK ,dokumentat provuese per vetdeklarimet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit,sic kerkohet ne piken 2.3.8, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatat (të vlefshme), si më poshtë:

- a. Çertifikatën SSH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- b. Çertifikatën SSH EN ISO 9001:2015 për “Menaxhimin e cilësisë”, ose ekuivalente/të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

➤ **Loti Nr. 5: “Blerje Ushqime”**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

1. Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 9).

2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.3.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023 dhe 2024**, lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës e përkatësisht **1,142,568 (një milion e njëqind e katërdhjetë e dymijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë**.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2025 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës **9** të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kerkohet në pikën 2.2.3, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit *nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit, që prokurohet dhe konkretisht **571,284 (pesëqind e shtatëdhjetë e njëmijë e dyqind e tetëdhjetë e katër) lekë**.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë liçensë me emërtimin përshkrues të veprimtarisë specifike sipas objektit të prokurimit të lotit 5 si më poshtë:

a. Liçensë lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

-Kategoria: II.1 -Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

-Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

b. Licença e mësipërme duhet të jetë e shoqëruar nga Akti i miratimit të zhvillimit të aktivitetit të lëshuar nga QKB.

(Sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore).

2.3.3 Nëse veprimtaria specifike sipas liçensës së operatorit ekonomik nuk është në përputhje me objektin e prokurimit të lotit 5 ky i fundit duhet të disponojë kontratë /a furnizimi nga subjekte që e zotërojnë *Liçensën e kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”* me veprimtari specifike sipas objektit të prokurimit (Lotit 5).

- a. Për të përmbushur këtë kriter duhet të paraqitet kontrata/t e furnizimit të vlefshme dhe *Liçencë të kategorisë “II.1.A.1-Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”* të furnitorit me veprimtari specifike sipas objektit të prokurimit (Lotit 5), e vlefshme të lëshuar nga QKB.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetëdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore në vendin ku ushtron veprimtarinë sipas liçensës të kërkuar në kriterin 2.3.2

Shënim: Operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi /ushqimet koloniale në adresat e përcaktuara nga Autoritetet Kontraktore përfituese potenciale.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti ATP (jo frigoriferik) për transportin e produkteve ushqimore/ushqime koloniale. Mjeti mund të jenë në pronësi, qera apo përdorim sipas rregullimeve ligjore. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë si :

- a. Akti që vërteton pronësinë ose Kontratë qeraje apo përdorimi (e vlefshme),
- b. Leje qarkullimi,
- c. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm),
- d. Sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (të vlefshëm).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ,duhet te dorezoje prane AK ,dokumentat provuese per vetdeklarimet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit,sic kerkohet ne piken 2.3.6 ,duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2(dy) punonjës, për të realizuar shërbimin e transportit dhe shpërndarjen e artikujve ushqimore objekt prokurimi sipas lotit 7 në destinacion, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1 nje
Punonjes shperndarje	1 nje
Total	2 dy

Për punonjësit e punësuar të paraqitet kontrate pune (e vlefshme).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ,duhet te dorezoje prane AK ,dokumentat provuese per vetdeklarimet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit,sic kerkohet ne piken 2.3.7 ,duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatat (të vlefshme), si më poshtë:

- a. Çertifikatën SSH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*
- b. Çertifikatën SSH EN ISO 9001:2015 për “Menaxhimin e cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*

V.O Ofertuesit ne plotesimin e ofertes se tyre nuk duhet të kalojnë vlerën e fondit limit të secilës drejtori te percaktuar me lart.Mosplotesimi i kesaj pike do sjell skualifikimin e ofertuesit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik” “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

⁶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie. Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005). Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit. Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. - Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. - Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
